

OSHEE Tirana 2015

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

OBJEKTI: "NDERTIMI I NEN STACIONIT TEC
KOMBINAT 110/20KV TIRANE"

Ligji N.10 440, date 7.7.2011
Shtojca II Kodi 3/a

INVESTITORI: OSHEE TIRANE

HARTOI RAPORTIN: Q-Plan International Network of Experts
Licence kodl 3.2.A: Nr. LN-9248-03-2015

Informacion mbi Studimin Paraprak te VNMS:

Titulli i projektit: NDERTIMI I NEN STACIONIT TEC KOMBINAT 110/20KV TIRANE

Procedura: VNM paraprake

Investitori: OSHEE Tirane

Harta e vendndodhjes se objektit dhe koordinatat ne sistemin GAUS KRUGE

Coordinates		
Coordinate System	Easting	Northing
ETRS83	19° 46' 54.5457"	41° 19' 9.9197"
UTM Zone 34N	396649.31	4574952.33
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4396738.64	4576914.27
KRGJSH 2010 / ETRS83 Transverse Mercator	480330.08	4576073.96

OK



PERMBAJTJA

Informacion mbi Studimin Paraprak te VNMS:	2
QELIMI I PROJEKTTI	5
HYRJE	6
KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV	9
Politika	9
Prioritetet strategjike.....	9
Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional.....	10
PERSHKRIMI I PROJEKTTI	13
Pozicioni gjeografik.....	13
Domosdoshmeria e ndertimit te N/St 110/20 kV Tec Kombinat.....	18
Parametrat kryesore te N/st te ri te Tec Kombinat	18
GIENDJA MJEDISORE BAZE	19
Statusi i zonës së studiuar dhe objektivi i projektit	19
Karakteristikat klimaterike.....	20
EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ	21
Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit	21
Variantet e zhvillimit në perspektivë	21
Mendimi i Komunitetit.....	22
Planet e zhvillimit urban te zones.....	22
Ekosistemet, habitatet dhe paisazhi egzistues	22
Trashegimia arkitektonike dhe historike	22
METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS	24
Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.	24
Metodika e kryerjes së VNM-së.....	24
IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	25
Zhurmat	33

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

Ndikimet në ujerat sipërfaqësore.....	33
Ndikimet në ujrat nëntokesorë.....	33
Perdorimi i tokës.....	33
Ndikimi në popullsi	33
Ndikimet në peisazh	34
Ndikimet e rrjetit elektrik 20kV mbi trashgimë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera njerëzore	34
Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë.....	34
NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLGJI	34
Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.	35
Ndikimet në cilësi dhe sasi të tokës	35
Ndikimet në ujë.....	35
Ndikimet e ndotjes dhe mbetjeve në cilësi të ujit	36
Ndikimet në ajër	36
Ndikimi në klimë	36
Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare, që shoqërojnë projektin.	36
Ndikimet shoqërore të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara.	36
Ekspozimi i fushës elektromagnetike.....	36
Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit	37
Rrymat Endogjene dhe Rrisku i Tyre.....	37
Efektet biologjike të fushave elektromagnetike.....	38
Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare.....	38
MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT	39
Masat e sigurimit teknik në punë	39
Mbrojtja e mjedisit	40
Masat e marra për zbutjen e rrezikut në mjedis dhe shëndet.	40
MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS.....	40
Matrica e ndikimeve në mjedis.....	41

Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe te Shfrytezimit.....	43
Plani i Masave Zbutese Dhe Monitoruese Mjedisore.....	45
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	45

QELLIMI I PROJEKTIT

Objektivi kryesor i këtij projekti është: Përmlrësimi i rrjeteve elektrike, rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, uljes së humbjeve dhe për tu përgjigjur në kohë zhvillimit urbanistik dhe demografik të zonës .

Objektiva specifike te projektit:

- Ndertimi i nje nenstacioni te ri elektrik ne zonën e Kombinatit
- Eliminimi gradual i N/stacioneve ekzistuese 35/6 kV, rrjetit te tensionit te mesem 35 kV, dhe 6 kV, duke i zevendesuar me transformimin direkt 220-110/20 kV dhe rrjetin e tensionit te mesem 20 kV.

Qëllimi i studimit është:

- Të japë një gjëndje sa më reale të ndikimit gjatë dhe pasi është realizuar “Ndërtimi i N/St Tec Kombinat 110/20 kV, Tiranë”, mbi mjedisin human e natyror.
- Vleresimin kompleks te ndotjes se ambientit te provokuar nga ky projekt ne terma te emetimit ne mjedisin akuatik, shkarkime hidrike, nderhyrje ne sipërfaqen e tokes, emetime zanore, mbetje, etj
- Përshkrimin e teknikave qe investitori kerkon te ndermarre per parandalimin e ndotjes, duke treguar nderhyrjet qe kane prirje te ulin emetimin ne ajer, ne uje dhe toke.

Projekti teknik jep nje permbledhje te te gjithë informacionit te mundshem per kushtet fillestare te zones, perfshire kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujore dhe kushtet social ekonomike. Keto kushte si dhe standardet dhe normat e aplikueshme jane mbajtur parasysh gjate procesit te kryerjes se Studimit, per te vleresuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale .

Studimi paraqet masa lehtesuese per te minimizuar ose per te parandaluar ndikimet sociale dhe ambientale te projektit. Keto perfshihen ne nje plan menaxhimi ambiental i cili konsiston ne vendosjen e masave lehtesuese, monitoruese dhe institucionale qe do te ndermerren gjate ndertimit dhe perdorimit pas zbatimit te projektit NDERTIMI I NEN STACIONIT TEC KOMBINAT 110/20KV TIRANE, per te eliminuar, kompensuar ose per te zvogeluar ndikimet sociale dhe mjedisore.

Ne studimin Mjedisor per ndertimin e ketij projekti, jane mbajtur parasysh elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit, te renditur si me poshte:

- Parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te cdo lloji
- Ruajtja e shumellojshmerise biologjike sipas bazes natyrore, biogeografike te vendit
- Perdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre
- Riaftesimi ekologjik i zonave te demtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukurite natyrore shkaterruese
- Ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe permiresimi i cilesise se jetes

Konkretisht studimi i VNM-se per problemin ne studim ka marre parasysh:

a) Ruajtjen maksimale te mundshme te mjedisit, e cila realizohet nepermjet:


- perzgjedhjes se zones me me pak ndikime negative ne mjedis,
- perzgjedhjes se zones me me pak ndikime negative ne biodiversitet,

b) Zhvillimin e qendrueshem te ekonomise se vendit, e cila realizohet nepermjet:

- Sigurimit te energjise elektrike me kosto te ulet
- Diversitetit te burimeve te prodhimit e te furnizimit me energji e lende te pare djegese, duke shmangur krizat e mundshme energjitike qe mund te vijne si pasoje e situatave te ndryshme gjeopolitike.

HYRJE

Rritja e shumefishte e popullsisë së Tiranës, përfshi rritjen e popullsisë shkaktuar nga migrimi i brendshëm i shpërthyer pas vitit 1991, si dhe rritja graduale por e qëndrueshme e standartit të jetesës dhe konsumit për qytetarët gjatë kësaj periudhe, kanë shtuar presionin për ndërtime të reja kryesisht të tipit rezidencial periurban apo të përqëndruar. Qyteti i Tiranës përjetoi gjatë kësaj periudhe një trysni të shumëfishuar ndërtuese ndaj territorit të tij urban.



Harta e shperndarjes se popullsisë ekzistuese sipas njesive strukturore, Tirane.

Për këtë shkak ka ndodhur një tjetërsim intensiv në përdorimin e tokës, duke konvertuar në truall ndërtimi sipërfaqe të gjera dikur me përdorim publik urban apo bujqësor në periferi të qytetit, dhe duke rritur intensitetin dhe koeficientin e ndërtimit. E lidhur në përpjestim të drejtë me këtë tendencë shfaqet rritja e popullsisë së Tiranës nga 250,000 në vitin 1990 në 350,000 në vitin 2001, dhe në rreth 500.000 në vitin 2011. Parashikimet e çojnë numrin e popullsisë së Tiranës së madhe në rreth 1 milion banorë në vitin 2025.

Në pjesën më të madhe, mënyra e akomodimit të kësaj rritjeje të popullsisë ka qenë e paplanifikuar, dhe e përqëndruar sidomos në zonat periferike të qytetit dhe në zonat e reja intensivisht të urbanizuara të tij. Kjo gjë ka vënë nën presion të madh edhe infrastrukturën dhe shërbimet ekzistuese, të cilat nuk kanë arritur t'u përgjigjen kërkesave në rritje si pasojë e këtij zhvillimi.

Me poshtë është paraqitur harta e zonës ku do të ndërtohet N/S1 I RI Tec Kombinatit



Zona e qyteti të Tiranës, ku bën pjesë dhe zona në cilën është menduar të ndërtohet *N/St i ri Tec Kombinat 110/20 kV në Tiranë*, është hapësirë e rëndësishme dhe e vlefshme në vend, e parë nga dy këndvështrime, nga ai i zhvillimit ekonomik dhe i vlerave mjedisore që ajo paraqet.

Shqipëria është Palë e një numri Konventash Ndërkombetare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashmë ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimin e impaktit ambjental të veprimtarive, shërbimeve apo ndërtimeve në mjedisin ku veprojnë.

Ky kuader ligjor dhe angazhimet ndërkombetare në fushën e mjedisit, shtrojnë shumë detyra ndaj Institucioneve për të zbatuar një sistem sa më efektiv për administrimin e mjedisit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit për prodhimin e energjisë elektrike, tashmë shumë problematike në Shqipëri dhe në rajon, por edhe të zbatimit të përgjegjësisve të rrjedhura nga këto marrëveshje ndërkombetare.

Me qëllim sigurimin e zhvillimit të qëndrueshem, gjatë aktiviteteve ndërhyrëse dhe shfrytëzuese të burimeve natyrore, duhet të kihet në konsideratë:

- Kursimi i energjisë dhe përdorimi i gjerë i burimeve rigjeneruese të energjisë
- Pakësimi i lëndëve djegëse dhe lëndëve të dëmshme për atmosferën
- Ruajtja dhe përkujdesja për tokën, florën dhe faunën
- Ruajtja dhe përkujdesja për burimet ujore

Gjatë periudhës së ndërtimit e shfrytëzimit, sipërmarrësi do të mbështetet në legjislacionin shqiptar, ligjet dhe normat e BE, si dhe në konventat ndërkombetare të nënshkruara nga Shqipëria dhe BE.

Në rastet kur projektet do të realizohen në bashkëpunim me donatorët, atëherë do të aplikohen Politikat Mjedisore të donatorit perkates, dhe legjislacioneve të zbatueshme për problemet mjedisore.

Studimi i vleresimit të ndikimit në mjedis u orientua nga rëndësia dhe madhësia e projektit, zona ku do të ndërtohet nën stacioni i ri elektrik, pasuritë natyrore dhe humane të zonës ku do të shtrohen gjashtë linderat e rlinj 20kV të cilat janë parashkuar të shtrohen pas ndërtimit të këtij nën stacioni në Tec Kombinat 110/20kV Tiranë, identifikimi i ndikimeve negative e pozitive, marrja e masave zbutëse, duke pasur parasysh gjëndjen aktuale të mjedisit ku do të zhvillohet veprimtaria, kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrën e përdorimit aktual të saj duke i harmonizuar ato me interesat ekonomike të investitorit dhe mjedisit human.

Gjatë dekadave të fundit veprimtari të ndryshme kanë ndikuar dukshëm në mjedisin rrethues në përgjithësi dhe në atë ujor në vecanti.

Këto ndikime, shpesh herë të njohura por edhe të panjohura, janë më të dukshme në impaktin që kanë në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin në përgjithësi.

KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Politika

Perditesimi i "Strategjise Kombetare te Energjise" per periudhen 2007-2020 eshte jo vetem ne mbeshtetje te VKM-se Nr. 424, date 26.06.2003 "Per Miralimin e Strategjise Kombetare te Energjise" deri ne vitin 2015, por eshte edhe nje kerkese e percaktuar nga angazhimet qe ka marre Qeveria ne kuadrin e Marreveshjes se Stabilizim - Asociimit, nga zhvillimet e fundit te sektorit te energjise sipas direktivave per Sektorin e Energjise te BE-se si dhe detyrimet qe dalin nga Traktati i Komunitetit te Energjise te Vendeve te Europes Juglindore i ratifikuar me lligjin Nr.9501 date 03.04.2006.

Vizioni i Strategjise Kombetare te Energjise eshte percaktimi i drejtimeve kryesore te zhvillimit te nje sistemi te sigurte energjetik, mbeshtetur ne parimet e tregut, per plotesimin e kerkesave per energji per konsumatorët me kosto minimale, duke patur ne konsiderate sigurine e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe permiresimin e mireqenies se popullates.

Prioritetet strategjike

Për realizimin e vizionit të mëslpërm janë përcaktuar prioritetet e për rrjedhojë:

1. Ristrukturimi i sektorit energjetik shqiptar, bazuar ne parimet e ekonomise se tregut dhe ne zhvillimin e nje politike bashkekohore energjetike per krijimin i nje kuadri efektly institucional, ligjor dhe rregullator te shoqerive publike energjetike me synim privatizimin e shpejte te tyre.
2. Nxitja e perdorimit eficient te energjise, ekonomik dhe me ndikim minimal ne mjedis, ne menyre te tille qe sektori energjetik te jete nje sektor mbeshtetes per nje zhvillim te qendrueshem te te gjithe sektoreve te tjere ekonomik dhe shoqeror.
3. Optimizimi i sistemit te furnizimit me burime energjetike, duke u mbeshtetur ne konceptin e planifikimit me kosto me te ulet dhe ndikim minimal ne mjedis.

4. Rritja e sigurise se furnizimit me burime energjetike nepermjet diversifikimit te sistemit energjetik dhe ndertimit te veprave te reja gjeneruese dhe linjave te interkonjeksionit.
5. Nxitja e perdorimit te burimeve te rinovueshme te energjise (diellore, HEC-et e vegjel, eres dhe biomases), per te bere te mundur shfrytezimin ne maksimum te burimeve lokale.
6. Hapja e tregut te brendshem te energjise elektrike dhe pjesemarrje aktive ne tregun rajonal te saj, ne kuadrin e Traktatit te Komunitetit te Energjise te Vendeve te Europes Juglindore, i cili bazohet ne kerkesat e Bashkimit European per reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 54/2003 e BE-se)

Strategjia Kombëtare e Energjisë parashtron kërkesat e domosdoshme për të plotësuar detyrimet e vendit tonë përkundrejt Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike në vëndet e Europës Jug-Lindore. Për këtë vendi ynë duhet të plotësojë të gjitha obligimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të harmonizojë zhvillimin e sektorit energjitik në përputhje me Direktivat e Bashkëpunimit European, për të bërë të mundur asocimin e Shqipërisë në Europën e Bashkuar.

Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional.

Metodologjia e hartimit te VNM

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 te ketij ligji ,percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ,sipas shtojces II (pika 3.a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë, i nenshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis;

Gjithashtu hartimi i ketij raporti fillestar te procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte bere ne perputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011"Per Mbrojtjen e Mjedisit"i ndryshuar, i cili është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Metodologjia e hartimit te VNM eshte hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor te shprehura ne Vendimin Nr. 686, date 29.07.2015, "Per miratimin e rregullave, pergjegjesive dhe afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore".

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis te shkaktuara nga proceset e permendura me lart jane percaktuar per pritesit ne mjedis te ketyreve ndikimeve.

- Ekosistemetet natyrore, fauna dhe flora
- Toka dhe nentoka
- Hidrologjia ne mjedis (ujrat tokesore dhe ata nentokesore)
- Cilesia e ajrit
- Klima
- Peisazhi
- Shendeti publik dhe cilesia e jetes
- Pronesia (ndertimet e ndryshme dhe tokat bujqesore)
- Trashegimia kulturore, duke permbajtur ndertimet arkeologjike dhe ato tradicionale

Gjatë plotësimit të kërkesave hartuesit e ketij raporti grumbulluan informacionin e domosdoshëm, që përfshin:

- a) kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- b) ndërtimin e objekteve dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;

- c) proceset teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- d) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- e) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre;
- f) gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- h) gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit.

Kuadri Ligjor Vendor dhe Nderkombetar

Hartimi i kesaj VNM -je per zhvillimin e zones se projektit te pershkruar ne kapitujt ne vijim , eshte i mbikqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale per zbatimin me rigoroz te te gjitha ligjeve dhe normave te parashtuara ne ligjet perkatese sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre .Ne baze te legjislacionit , ky aktivitetet ndiqet nga keto institucione :

- Ministria e Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Bashkita perkatese ne te cilen zona e projektit ben pjese administratisht
- Instituti i mjedisit.;
- Instituti Hidrometeorologjik;

Kuadri ligjor vendor Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rëndësishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

- Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"
- Ligjin Nr .10 431, datë 9.6.2011 " Per Mbrojtjen e Mjedisit "
- Ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010'Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr8897 date 16/5/2002 'Per Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja "
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005, "Për eficiency e energjisë".
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".I ndryshuar me:

Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996: "Për largimin publik të mbeturinave"
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" I ndryshuar me

:Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" I ndryshuar me:

Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005

Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008

- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" I ndryshuar me:

Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

VKM Nr. 686, date 29.07.2015, "Per miratimin e rregullave, pergjegjesive dhe afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore".

- VKM. Nr. 835, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi"
- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006, "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

- V.K.M Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- V.K.M Nr.267, datë 24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike"
- V.K.M Nr.994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin".
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"
- VKM Nr.114, datë 27.01.2009 për "Marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- Vendim Nr.824, datë 11.12.2003 Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme
- Udhezim Nr.6527, datë 24.12.2004, "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre"
- Udhezim, Nr.6, datë 27.11.2007, "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta".
 - Urdhërin e Ministrit Nr. 137, datë 17.08.2004. "Për Dokumentacionin e Domosdoshëm për të Kërkuar Leje Mjedisore", etj.
 - Udhezim i përbashkët ; M M P A U dhe M SH nr.8, dt 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara".
 - VKM nr 587 date 07.07.2010 /Për Monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane e turistike".
 - Ligji Nr. 9072 datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike së bashku me të gjitha (me ndryshimet dhe shtesat sipas Ligjit nr. 9512 date 10.04.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072 datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Shqipëria është një vend i cili është tashmë nënshkruar i shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky raport duhet të pershtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe me poshte ilustrohen në mënyrë të përbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit .

- Protokollin e Kievit :Për vlerësimin strategjik mjedisor.Ratifikuar në vitin 2005
- Protokollin e Kartagjens:Për biosigurinë .Bere pale në vitin 2005
- Konventa e Stockholmit:Mbi ndotësit organikë të qëndrueshem. Ligji nr. 9263, date 29.07.2004
- Protokollin e Kartagjens :Për sigurinë biologjike .Ratifikuar në vitin 2004.
- Ligji nr. 9279, date 23.09.2004
- Konventa e Washingtonit:Për tregjetin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të flores dhe faunes se eger. Ligji nr. 9021, date 06.03.2003

Kuadri Ligjor European

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqësojë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës,Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.

- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujerave të embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimit të projektit në mjedisin fizik dhe special. Ky proces zhvillohet brenda atij të planifikimit dhe zbatimit të projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre.

Në vijim janë përshkruar vecorit kryesore të projektit, të cilat, së bashku me investigimet në vendndërtimin e parashikuar të ushtrimit të aktivitetit, kanë shërbyer për identifikimin e ndikimeve në mjedis të objektit "Ndërtim i N/St Tec Kombinat 110/20kV Tiranë".


PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Pozicioni gjeografik

Ndërtimi i Nën Stacionit parashikohet të realizohet në perëndim të Tiranës, në zonën e Kombinatit.

Qyteti dhe rrethi i Tiranës përfaqëson një zonë me zhvillim mjaft intensiv të objekteve prodhuese industriale, shërbimeve, etj. Këta faktorë kanë bërë që ritmet e rritjes së kërkesës për energji elektrike për qytetin të jenë mjaft të larta. Është e qartë që për të paraprirë nevojave për furnizimin me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duhet zhvilluar një infrastrukturë elektrike e pershtatshme, që të garantojë një shërbim cilësor kundrejt konsumatorëve aktualë dhe njëkohësisht të jetë në përputhje me zhvillimet e pritshme afatgjata të qytetit dhe zonës së Kombinatit.

Për të përcaktuar zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes në zonën e Kombinatit në qytetin e Tiranës si dhe realizimin e ndërtimit të një N/stacioni 110/20 kV në zonën Kombinat, për kryerjen e studimit perkates me terma kryesore të punës si më poshtë:



- Peshkrimi i n/stacionit ekzistues Tec Kombinat 35/6kV rrjetit shperndares 6kV, duke konsideruar te gjithe faktoret , teknik ekonomik dhe organizativ.
- Nevoja për ndërtimin e N/St Tec Kombinat 110/20 kV dhe rrjetin e saj të shpërndarjes 20 kV për furnizim me energji elektrike për klientët e rinj dhe për të zëvendësuar rrjetin 6kV të shpërndarjes në 20 kV përmes këllij n/stacion.
- Përcaktimi i vendit të ndërtimit, numri i transformatorëve të fuqisë dhe fuqia e tyre ,si dhe zhvillimi dhe perspektiva.

Rrjeti i furnizimit me energji elektrike te zones se kombinatit eshte konceptuar dhe zhvilluar edhe ne baze te studimeve te meparshme.

Sipas ketyre studimeve eshte vleresuar qe:

1-Transformimi 35/6 kV eshte nje hallke e tepert midis tensionit 110 kV dhe tensionit te mesem te sistemit te shperndarjes.

2-Rrjeti i Tensionit te Mesem 6 dhe 10kV eshte i amortizuar dhe me seksione te vogla te perciellesve te linjave, eshte krejt i pa pershlatshem me humbje te larta te energjise elektrike, renie te theksuar te tensionit dhe kapacitet shume te limituar.

Per kete qellim studimet kane percaktuar eliminimin gradual te N/stacioneve 35/6 kV, rrjetit te tensionit te mesem 35 kV, dhe 6 kV, duke i zevendesuar me transformimin direkt 220-110/20 kV dhe rrjetin e tensionit te mesem 20 kV.

Foto nga zona ku eshte parashikuar ndertimi i N/St te ri Tec Kombinat Tirane



Siperfaqja totale qe do te zihet nga projekti parashikohet te jete rreth 2,000 m². Nderkaq, ndertesat me te aferta te banuara ndodhen minimumi 100 m larg kufirit perkates te nenstacionit.

Rrjeti i Tensionit te Mesem.

Rrjeti i tensionit te mesem 20kV do te zhvillohet duke zevendesuar gradualisht rrjetin 6kV dhe 10kV. Struktura e rrjetit 20 kV ne zonen urbane dhe rurale eshte kryesisht ne forme ishulli. Fiderat qe dalin nga N/Stacioni mbyllen ne unaze ose lak me njera tjetren.

Fiderat jane pergjithesisht me seksion terthor te njejte (kablo njepolar XLPE 185 mm² ose 240 mm²) ne te gjithe gjatesine e tyre, per te mundesuar furnizimin nga te dy skajet deri ne kufirin termik maksimal. Ne kushte normale kablul operojne te hapur ne nje kabine transformacioni, afersisht ne mesin e gjatesise se tyre.


Per te perfitur optimumin ekonomik te perdorimit te rrjetit 20 kV, ngarkesa e zones duhet ndare sa me shume te jete e mundur e barabarte ndermjet fiderave.

Kabllo e tensionit te mesem 20 kV li XLPE do te shtrihen ne toke ne thellesine 1.2 meter ne keto kushte mesatare pune:

- Temperatura e tokes 150 C
- Temperatura e lejuar e punes 900 C
- Rezistenca termike specifike e tokes 1.0 K.m/W
- Menyra a shtrirje gershet
- Faktori i ngarkeses 0.6

Analize projekti.

Kerkesa per energji elektrike ne zonen Kombinatit per kater vite e fundit (2011-2014) eshte rritur rreth 4.6 % . Percaktimi i kerkeses per energji elektrike bazuar ne te dhenat retrospektive (te mepareshme) ka qene i veshtire, pasi ne vitin 2014 sic shikohet ka nje ulje te konsumit ku OSHE mori nje aksion per nderpr`erjet energjise abuzuesve dhe lidhjeve te paligjishme .



Zona ne te cilen eshte parashikuar te zhvillohet rrjeti 20kV

Konsumi i energjise per fiderat e n/stacionit Tec Kombinat

NR.	Nenstacioni	Emri i Fiderit	Emri i Fiderit sipas Faturimit	Tensioni (kV)	Energjia Viti 2011 (kWh)	Energjia Viti 2012 (kWh)	Energjia Viti 2013 (kWh)	Energjia Viti 2014 (kWh)	Rritja Energjia %
1	Tec Kombinat 35/6 kv	Fidri 1	1Ø	6	2,097,144	1,954,728	1,928,088	2,105,334	6.79
2		Fidri 2	2Ø	6	6,842,214	7,730,760	10,128,168	9,469,008	-12.99
3		Fidri 3	3Ø	6	11,675,664	12,214,728	12,569,856	12,115,992	-4.62
4		Fidri 4	4Ø	6	1,335,576	590,238	807,786	946,926	55.81
5		Fidri 5	5Ø	6	6,605,352	6,200,966	6,828,732	7,388,856	6.12
6		Fidri 6	6Ø	6	1,578,654	1,362,950	1,549,710	1,569,660	13.66
7		Fidri 8	8Ø	6	9,753,472	10,475,712	10,952,496	10,698,672	-7.40
8		Fidri 9	9Ø	6	752,022	82,620	134,260	110,630	89.01
9		Fidri 10	10Ø	6	65,440	68,310	56,010	56,090	-4.39
10		Fidri 11	11Ø	6	17,041,572	19,331,526	19,719,264	17,498,828	-13.44
11		Fidri 12	12Ø	6	7,436,362	6,742,080	7,023,600	6,747,120	9.34
12		Fidri 18	18Ø	6	13,812,340	14,135,620	13,025,640	12,417,724	-2.34
13		Fidri 19	19Ø	6	7,449,380	7,241,470	7,299,402	9,279,144	2.79
Totali					86,445,192	88,131,708	92,023,012	90,403,984	4.58

Sic shihet ritmet e rritjes se konsumit te energjise elektrike per zonen e Kombinatit qene teper te larta. Kjo shpegohet me migrimin e popullsise nga zonat malore te vendit ne drejtim te periferive

te qyteteve te medha, vecanerisht ne drejtim te periferise se Tiranes, ku kufijte e komunave qe e rrethojne ate, praktikisht jane zhdukur.

Domosdoshmeria e nderimit te N/St 110/20 kV Tec Kombinat.

- Nje shfrytezim me te mire te rrjetit 20 kV dhe siguri me te larte te furnizimit te ngarkesave te rendesishme,
- Krijimin e mundesive te N/stacioneve te tjere per te zhvilluar me tej rrjetin e TM 20 kV ne zonat periferike te qytetit qe ende furnizohen nga rrjeti 6 kV.

Parametrat kryesore te N/st te ri te Tec Kombinat

N/Stacioni qe furnizon me energji elektrike Kombinatit dhe ngarkesat me te rendesishme te tij, duhet te garantoje nje standart teper te larte te sigurise dhe cilesise se sherbimit te energjise elektrike. Pra ne vend te N/stacionit 35/6kV duhet te ndertohet nje N/Stacion i ri me skeme lidhjeje te sigurte dhe me nje fuqi te instaluar qe ti sherbeje dhe nje perspektive afatgjate.

Per kete arsye N/St 110/20 kV i Tec Kombinat duhet te plotesoje keto kerkesa kryesore.

1. N/stacioni duhet te jete me fuqi te garantuar nga rrjeti i transmetimit. Kjo do te thote qe ai duhet te kete me shume se nje linje furnizimi nga rrjeti i transmetimit 110kV, me aftesi transmetuese per te mbajtur fuqine e plote te N/stacionit ne rast demtimit te njeres prej linjave.

2. N/stacioni duhet te kete gjithashtu me shume se nje transformator dhe te garantoje mbullimin e plote te ngarkeses ne rast se njeri prej transformatoreve del jashte funksionit. N/stacioni mund te garantoje furnizimin e pjeshem te ngarkeses ne rast se nje transformator del nga funksioni, nese rrjeti i TM 20kV eshte ne unaze dhe nje pjese e ngarkeses mund tju kaloje fiderave te n/stacioneve fqinje.

Duke vleresuar te gjitha faktoret e mesperm, gjykojme qe N/stacioni 110/20 kV i Tec Kombinat duhet te jete i paisur me dy transformatore 110/20 kV me fuqi 40 MVA secili. Furnizimi i tij nga rrjeti i transmetimit do te behet nepermjet linjes kablore 110 kV qe dalin nga N/stacioni i ri 400/220/110 kV i Tiranes.

N/stacioni do te kete nje zbare 110 kV te ndare me buscoupler dhe dy seksione zbarash 20 kV te ndare me seksionues te paisur me celes SF6.

Analiza ekonomike.

Percaktimi i perfitimeve te realizuara nga ky projekt analizohen ne dy drejtime: perfitime qe i vine komunitetit dhe perfitime te kompanise.

Per te percaktuar raportin kosto/perfitim nga nderlimi i N/st Tec Kombinat do te krahasojme dy raste:

- Rasti me n/stacion 35/6kV 23MVA
- Rasti me nderimin e N/stacionit te ri Tec Kombinat 110/20 kV 2x40 MVA dhe mbullimin e kerkeseses prej tij dhe N/stacioneve te tjere ekzistues.

Krahasimin e te dy rasteve do ta bejme ne drejtim te reduktimit te humbjeve ne rrjetin e TM. Nga ana tjetere ne zerin e shpenzimeve pervec investimeve per realizimin e projektit do te pranojme dhe nje kosto per operim dhe mirembajtje ne vleren 2% te vleres se plote te projektit.

Investimet e kompanise

Investimet per realizimin e N/stacionit 110/20 kV te Tec Kombinat perفشijne:

1. Lidhja me linjen 110 kV qe del nga N/st 400/220/110 kV Keshar qe shkon drejtim n/st. Selite 110/20/35/10kV.
2. N/stacionin 110/20 kV te Tec Kombinati perbere nga:
 - Impjanti 110kV
 - Dy transformatore 110/20 kV me fuqi 40 MVA sejcili.
 - Dy dalje linje (line bay) 110 kV
 - Dy dalje transformatori (transformator bay) 110 kV
 - Impjantin shperndares 20kV i perbehet:
 - Dy cela hyrje te transformatoreve
 - 18 cela per fiderat dales
 - Dy cela per transformoret e nevojave vetjake
 - Dy cela per transformoret e tensionit.

Perfitimet


Reduktimi i humbjeve te energjise elektrike

Me ndertimin e N/st te ri 110/20 kV te Tec Kombinat mundesohet nje regjim pune me i mire i rrjetit 20 kV, qe si pasoje sjell dhe reduktimin e humbjeve te fuqise. Sipas llogaritjeve te bera per rrjetin aktual, ne se n/st do te ishte ne pune do te kishim nje reduktim te humbjeve.

GJENDJA MJEDISORE BAZE

Statusi i zonës së studiuar dhe objektivi i projektit

Zona e ndërtimit të objektit tonë të studimit nuk është e mbrojtur me ligj si *park kombëtor*. Ndërtimi i Nën Stacionit dhe ndërtimi i fiderave të rinjë është në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nuk cënon aspak statusin dhe karakteristikat e zonës. Nevoja për ndërtimin e Nën Stacionit elektrik brenda kondicioneve tekniko-mjedisore, për situatën që po kalon vendi ynë dhe rajoni, është nevojë imediate.



Ha

arta e Tiranës Trashëgimia Kulturore dhe Historike

Karakteristikat klimaterike

Hapësira Tirane-Durrës përfshihet në zonën klimatike mesdhetare fushore të Shqipërisë. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimra të butë dhe të lagët dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Vendmatjet bazë që kanë shërbyer për studimin e veçorive klimatike të zonës janë Tirana, Kamza dhe Sukthi ndërsa si periudhëlogaritëse janë marrë vrojtimet 1961-1990, periudhë bazë klimatologjike e rekomanduar dhe nga organizmat ndërkombëtare të specializuara.

Diellzimi

Një nga elementet bazë që karakterizon klimën e një zone është regjimi i diellzimit që shprehet nëpërmjet numrit të ditëve të kthjellta dhe atyre të vranëta. Për zonën në studim, numri i ditëve të kthjellta luhet nga 6-7 ditë në muajt e dimrit dhe 16-19 ditë në muajt e verës. Për ditët e vranëta situata paraqitet në kahe të kundërt dhe konkretisht mesatarisht gjatë vitit vrojtohen rreth 1-2 ditë të vranëta në kohën e verës dhe 10-12 ditë të tilla në kohën e dimrit. Një parametër tjetër që karakterizon regjimin e diellzimit është rrezatimi i përgjithshëm diellor që shpreh energjinë diellore e shprehur në kalori për njësi të sipërfaqes kal/cm². Për hapësirën Tiranë-Durrës ky lloj parametri matet vetëm në vendmatjen e Tiranës dhe në bazë të të dhënave rezultojnë se

vlerat mujore të rrezatimit të përgjithshëm luhaten nga 135.6kal/cm² në muajin dhjetor deri 570 kal/cm² ne muajin korrik. Këto shifra tregojnë një potencial të konsiderueshëm energjie diellore në zonën në studim, gjë që presupozon kushte shumë të favorshme për zhvillimin ekonomik të kësaj zone.

Temperatura e ajrit

Një element shumë i rëndësishëm në karakterizimin e klimës të një zone të caktuar është dhe regjimi i temperaturave. Parametrat me kryesore që shprehin regjimin e temperaturave janë temperaturat mesatare dhe ato ekstreme (minimale dhe maksimale). Hapësira Tiranë-Durrës paraqitet pak a shumë homogjene për sa i përket regjimit të temperaturave. Kështu temperatura mesatare vjetore luhatet nga 15 deri 16°C, ndërsa muaji me i ftohtë, që është janari, karakterizohet nga një luhatje e temperaturës nga 6.6 deri ne 8.3°C, ndërsa muaji me i ngrohtë, korriku, ka temperaturë mesatare që luhatet nga 23 deri ne 24°C. Po kështu edhe për temperaturat ekstremet situata paraqitet pak a shume e njëjtë.

Reshjet e hapësirës Tiranë-Durrës karakterizohen nga vlera jo të larta, që arrijnë deri në 1200 mm në vit, ndërkohë që mesatarja vjetore në rang vendi është rreth 1450 mm. Karakteristika kryesore e tyre është se sasia më e madhe bie gjatë periudhës së ftohtë të vitit, ku rekordin e mban muaji nëntor me 13-14 % të reshjeve vjetore, ndërsa muaji me më pak reshje është korriku me 3 % të reshjeve vjetore.

Zona e ndërtimit te objektit tonë të studimit nuk është e mbrojtur me ligj si *park kombëtar*. Ndertimi i rrjetit elektrik është ne përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nuk cënon aspak statusin dhe karakteristikat e zonës. Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit te rrjeteve elektrike, uljen e ngarekesave në N/Stacione, linja TM, Kabina dhe rrjet TU, për rritjen e cilësise së furnizimit me energji elektrike, uljes së humbjeve dhe për t'ju përgjigjur në kohë zhvillimit urbanistik dhe demografik të zonës.

EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit

Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit te rrjeteve elektrike, uljen e ngarekesave në N/Stacione, linja TM, Kabina dhe rrjet TU, për rritjen e cilësise se furnizimit me energji elektrike, uljes së humbjeve dhe per t'ju përgjigjur në kohë zhvillimit urbanistik dhe demografik të zonës.

Variantet e zhvillimit në perspektivë

Shtimi i kërkesave të tjera për energji elektrike, kërkon të bëhet i mundur shfrytëzimi me eficience i kapaciteteve ekzistuese, për të punuar me ngarkesë mesatare dhe në pik, për plotësimin e nevojave dhe si rrjedhim do të ketë një impakt pozitiv duke lehtësuar shkëmbimin e energjisë. Mbështetur në investimin që do të realizohet do të kemi një shtim të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.

Ndërkohë, duke përfshirë në projekt ndërtimin e linjave të tensionit të mesëm të transmetimit të energjisë, do të kemi dhe ulje të ndjeshme ë humbjeve teknike, po

kështu rajoni do të furnizohet me energji me parametra nominale.

Rrjeti transmetues është përgatitur në mënyrë të tillë që të mbulojë nevojat me një kosto minimale, humbje minimale, ndikim minimal në mjedis dhe me një shërbim cilësor e të mjaftueshëm.

Mendimi i Komunitetit

Për zhvillimin e këtij projekti i ka kushtuar njëvëmëndje të vecantë bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe komunitetin. Që në fillimin e studimeve përkatëse për këtë projekt, është marrë kontakt me drejtuesit e Bashkisë Tiranë dhe komunitetin përreth, duke i kërkuar miratimin në parim të projektit për e fiderave të rinjë e Nën Stacionit elektrik.

Planet e zhvillimit urban te zones


Zhvillimi i kësaj hapsire parashtron disa kërkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendim marrësve. Projekti i ndërtimit të Nën Stacionit elektrik, gjithmonë duke minimizuar efektet negative në peisazhin e kësaj zone, do të kontribuojë në furnizimin me energji elektrike të pandërprere dhe me parametra të mirë. Gjithashtu shoqëria është mjaft e vëmëndshme ndaj kërkesave të komunitetit dhe ka ndërtuar një plan për përmirësimin e kushteve aktuale të zonës.

Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi egzistues

Zona në të cilën ndodhet Nën Stacioni elektrik dhe traseja e përcaktuar për tu ndërtuar gjashtë fiderat e rinjë janë zona me një peisazh tërheqës të një zonë me aktivitet kryesisht biznes por edhe banimi, kohët e fundit me aktiviteteve të ndryshme ekonomike.

Trashegimia arkitektonike dhe historike

Gjatë fuqizimit të Nën Stacionit nuk mundet të takohen objekte dhe trashëgimi që bartin vlera kulturore. Në zonën në fjalë nuk njihen site arkiologjike, pra dhe dëmtimi i tyre është i pamundur.



METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë më standartet bashkëkohore, për zhvillimin e të gjithë sektorëve energjike.

Qëllimi i Strategjisë së Energjisë ka të bëjë me zhvillimin sa më efektiv të sektorit energjetik:

- 1) Garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike.
- 2) Sektori energjetik është një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektoreve ekonomik.

Qëllimi i hartimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është marrja parasysh e faktoreve që ndikojnë në mjedis gjatë ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij.

Ky raport është pjesa më e rëndësishme e dokumentacionit të kërkuar, në zbatim të procedurës së nevojshme gjatë procesit të miratimit të lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qëllim të japë një vështrim të përgjithshëm mbi efektet në mjedis, alternativat e mundëshme dhe masat zbutese të efekteve të padëshirueshme.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është një studim që synon parashikimin e të gjithë efekteve të pritshme në mjedis, që do të rezultojnë nga një projekt i propozuar, si gjatë zbatimit ashtu dhe gjatë funksionimit të tij. VNM-ja përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimit cilësor me pika të ndikimeve në mjedis të projektit.

Propozime të masave zbutese të ndikimit në projekt, etj.

Qëllimi i këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i përgatitur për rastin e ndërtimit të Nën Stacionit elektrik Tec Kombinat 110/20kV Tiranë është që të identifikojë pasojat e mundëshme negative mjedisore që mund të krijohen gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të këtij nën stacioni.

Gjithashtu një tjetër synim i këtij Raporti të VNM-së është të përcaktojë e të rekomandojë masat tekniko-organizative për zbutjen e faktorëve negativë që ekzistojnë dhe të atyre që krijohen gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tij.

VNM-ja e këtij projekti është hartuar për të integruar mbrotjen ambientale në jetën e përditshme, që të udhëheqë në ndryshimin e sjelljes së komunitetit, duke u bërë në këtë mënyrë forca shtytëse e përmirësimit të vazhdueshëm.

Metoda më e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e list kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve, dhe nga ana tjetër mbartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit.

Metodika e kryerjes së VNM-së

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua:

- Nga rëndësia e fuqizimit dhe ndërtimit e shfrytëzimit të rrjetit elektrik 20 kV me standartet bashkëkohore,
- Nga përmbushja e kërkesave vëndase dhe të huaja,
- Nga vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore e humane të zonës si dhe vlerave të vecanta të tyre,
- Në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- Në marrjen e masave zbutëse, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike të investimit,
- Në masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm etj.

Në këtë raport identifikohen ndikimet lokale e negative në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh vlerësimi i rrezikut.

Reduktimi i ndikimeve negative, është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme lokale dhe strukturore në keto faza kryesore:

- Hartimi i objektivave orientuese të Raportit të VNM-së;
- Mbledhja e materialit bazë eksistues dhe plotësimi i formularit përkatës për këtë raport (relacioni teknik, projekt-preventiv etj), si dhe seleksionimit të tyre për përdorim.

Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundëshme blfizike dhe humane:

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Nga vlerësimi i veçorive kryesore të projektit, dhe me investigimet në zonën e parashikuar për ndërtimin e nën stacionit elektrik, është bërë identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundëshme në mjedis në zonën ku do të zbatohet projekti.

Në përputhje me Udhëzimin Nr.6, datë 27.12.2006 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie" me keto identifikime dhe vlerësime është plotësuar tabela I e Aneksit II të këtij udhëzimi për të analizuar në mënyrë të detajuar vlerësimet sasiore të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit të ndërtimit.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT " NDERTIM I NEN STACIONIT TEC KOMBINAT 110/20KV NDERTIMIT TE RRJETIT 20KV TIRANE"

Nr.	Pyetje qe konsiderohen ne fazen e perzgjedhjes	Po /Jo	Cilet elemente te mjedisit mund te ndikojne e si?	Do te jete ndikimi domethenes ne mjedis? Pse?
1. A do te perfsheje ndertimi, operimi ose mbyllja e veprimtarise dhe montimi i teknologjise dhe pajisjeve veprimte qe te shkaktojne ndryshime fizike ne topografi, perdoim toke, ndryshime ne trupat ujore etj ?				
1.1	Ndryshime te perkoheshme ose te perhereshme ne përdorimin e tokes, mbulesen e tokes ose topografin, duke perfsheire rritjen e	Po	Pjese te tokes ku do zbatohet projekti prtr ndertimin e N/St te ri, rrjetit te ri 20 kV.	Jo (Ndertimi do te jete komfort te gjitha standarteve te kerkuara).

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

	intensitetit te perdornit te tokes.			
1.2	Pastrimia e tokes ekzistuese, vegjetacionit dhe ndertimeve ekzistuese?	Jo	-	-
1.3	Krijimin e perdorimeve te reja te tokes?	Jo	-	-
1.4	Investigjme para fazes ndertimore , si shplme per marrjen e mostrave, provat e tokes, dheut ?	Jo	-	-
1.5	Punime ndertimi?	Po	Ndertim i godines se kontrollit te nen stacionit te ri, vendosja e kablnave Box ne fazen e ndertimit te linjave 20kV	Po (Do te zbatohen kushtet teknike te ndertimit gjate)
1.6	Punime prishjeje?	Jo		Jo (mbetjet do te mblidhen dhe transportohen ne vend grumbullimet te caktuara)
1.7	Kantieret te perkoheshme per punime ndertimi ose strehimi per punetoret?	Po	Gjate fazes se ndertimit do te ketë kantieret per materialet e domosdoshme te ndertimit.	Jo(Do te krijohen ne territorin e punimeve)
1.8	Punime mbitokesore, struktura ose punime te tokes, germime ose mbushje?	Po	Do te kryhen germime, per ndertimin e nen satlonit te ri, germimet per hapjen e kanaleve per shtrimin e fiderave te rinje.	Jo(Do te zbatohen te gjitha kushtet e ndertimit te parapercaktuar)
1.9	Punime nentokesore, miniera ose tunele?	Jo	-	-
1.10	Punime bonifikuese?	Jo	-	-
1.11	Germime per hapje kanalesh?	Jo	-	Jo (Ne nje faze te dyte kur te shtrihen fiderat e rinje)
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?	Jo	-	-
1.13	Struktura ne det?	Jo	-	-
1.14	Procese te ndryshme prodhimi?	Jo	-	-
1.15	Mjedise per magazinim te madhrave e materialeve te ndryshme?	Po	Nuk do ketë ndikim ne mjedis	Jo (do perduren ambiente ekzistuese)
1.16	Impiante per trajnimin ose depozitimn e mbetjeve te agurta e te lengeshme?	Jo	-	-
1.17	Objekte per strehimin e punetoreve te shfrytezimit?	Jo	-	-
1.18	Ruge e re, hekurudhe, trafik detar, gjate fazes se ndertimit e shfrytezimit?	Jo	-	-
1.19	Ruge e re, hekurudhe, ajrore, ujore ose infrastruktura te tjera	Jo	-	-

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

	transporti, perfshtire dhe ruge e stacione te reja ose te alternuara porte e aeroportete?			
1.20	Mbyllje apo devijim i rrugëve ekzistuese që kanë ndryshime në lëvizjet e trafikut?	Jo	-	-
1.21	Linja ose tubacione të reja transferuese	Jo	-	-
1.22	Rezervuar, argjinatura, kanale nëntokesore, rregullime apo ndryshime të tjera në hidrologjinë e rjedhëve ujore apo akuifereve?	Jo	-	-
1.23	Nderprerje të rrymave?	Jo	-	-
1.24	Nxjerrje ose transferim të ujit nga nëntoka ose sipërfaqet ujore?	Jo	-	-
1.25	Ndryshime në trupat ujore ose në sipërfaqet e tokës që ndikojnë në drenimin ose largimin e ujrave?	Jo	-	Jo
1.26	Transportin e personelit e materialeve të ndërtimit, shfrytëzimit e mbeturinave?	Po	Nuk do kënaqë ndikim mjedisor	Jo (nuk ka ndikim domethënës)
1.27	Punime afatgjatë cmontimi, nxjerrjen e mbeturinave ose punime restauruese?	Jo	-	Jo
1.28	Veprimtari gjatë ndryshimit të destinacionit që mund të kënaqë ndikim në mjedis?	Jo	-	-
1.29	Hyrjen e njerezve në një zonë perkohesisht ose në mënyrë të vazhdueshme?	Jo	-	-
1.30	Futjen për kultivim të specieve joendase?	Jo	-	-
1.31	Humbjen e specieve vendase ose diversitetit gjenetik?	Jo	-	-
1.32	Ndonjë veprim tjetër?	Jo	-	-
<p>2. A do përdoren gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit burimet natyrore të tilla si: toka, uji, materiale ose energji, ndonjë nga burimet që janë të rinovueshme ose të kufizuara?</p>				
2.1	Tokë vecanerisht e varfer apo tokë bujqësore?	Jo	-	-
2.2	Uji?	Jo	-	-
2.3	Minerale?	Jo	-	-
<p>Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes</p>				

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

2.4	Grumbullime lëndesh ndertimi (zhavor etj)	Po	Nuk do kene ndikim mjedisor	Jo (pas ndertimit do rehabilitohet toka e perdorur per grumbullim inertesh)
2.5	Pyje dhe lende drusore	Jo	-	-
2.6	Energji, elektrike apo lende djegese?	Po	Nuk do kene ndikim mjedisor	Jo
2.7	Ndonje burim tjetere?	Jo	-	-
3. A do te perfshije projekti perdorimin, ruajtjen, transportin,perpunimin dhe prodhimin e substancave ose materialeve qe mund te jene te domshem per shendetin e njerezve ose mjedisin dhe qe rrisin shqetesimin mbi rezilqet aktuale dhe te mundshme ne shendetin e njerezve?				
3.1	A parashikon projekti perdorimin e substancave ose materialeve te rrezikshme ose toksike per njerzit dhe mjedisin?	Jo	-	-
3.2	Do rezultoje projekti ne ndryshime me shfaqje semundiesh ose efekt ne vektoret e semundjeve	Jo	-	-
3.3	Do ndikojte projekti ne mireqenien e njerezve ?	Po	Impakt pozitiv	Permiresim te furnizimit me energji elektrike, hapen vende pune.
3.4	A ka grupe njerezish qe mund te ndikohen nga projekti,p.sh. te semuret apo te moshuarit?	Jo	-	-
3.5	Shkaqe te tjera?	Jo	-	-
4. A do te prodhohen mbeturina te ngurta, gjate ndertimit, shfrytezimit ose njerje jashte funksionit?				
4.1	Mbeturina dherash zhavori ose minierash?	Po	Nuk do kene ndikim mjedisor	Jo(pas ndertimit do rehabilitohet toka e perdorur per grumbullim inertesh)
4.2	Mbetje urbane(shtepiake ose tregetia) ?	Jo	-	-
4.3	Mbetje te rrezikshme e toksike apo radioaktive?	Jo	-	-
4.4	Mbetje te tjera te proceseve industriale?	Jo	-	-
4.5	Produkte shtese?	Jo	-	-
4.6	Ujra te zeza ose llumra te tjera nga trajtimet e	Jo	-	-

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

	shkarkimeve te lengeta?			
4.7	Mbetjet nga ndertimet ose shembjet?	Po	Nuk do kene ndikime mjedisor	Jo(pas ndertimit do rehabilitohet toka e perdorur per grumbullim inertesh)
4.8	Mbeturina makinash ose pajisjesh?	Jo	-	-
Pyetje qe duhet te mbahen parasysh gjate perzgjedhjes				
4.9	Toka te ndotura ose materiale te tjera?	Jo	-	-
4.10	Mbetje bujqesore?	Jo	-	-
4.11	Mbetje te tjera te ngurta?	Jo	-	-
5. A do te shkarkohen ndotes ne ajer ose cdo substance tjeter e rrezikshme toksike apo e demshme per shendetin nga projekti?				
5.1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve nga burime stacionare ose te levizshme?	Jo	-	-
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	Jo	-	-
5.3	Shkarkime nga perpunimi i materialeve, perfshi depozitimin ose transportin?	Jo	-	-
5.4	Shkarkime nga aktiviteti i ndertimit perfshi impiantet dhe pajisjet?	Jo	-	-
5.5	Mbetje ose erera sulmuese nga perpunimi i materialeve te ndertimit, ujrave zeza e mbetjet?	Jo	-	-
5.6	Shkarkime nga inceneratoret e plehrave?	Jo	-	-
5.7	Shkarkime nga djegija e mbetjeve ne ajer?	Jo	-	-
5.8	Shkarkime nga burime te tjera?	Jo	-	-
6. A do te shkaktoje projekti zhurma dhe vbraclone ose emetime te drites, energjise termike ose rrezatim elektromagnetik?				
6.1	Nga puna e pajisjeve si: motora, franto, ventilus?	Jo	-	Jo

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

6.2	Nga procese industriale apo te ngjajshme?	Jo	-	-
6.3	Nga ndertime apo prishje?	Po	Nuk do ketë ndikime mjedisore	Jo (punimet brenda të gjitha kushteve teknike të domosdoshme)
6.4	Nga plasje apo futje pilotash	Jo	-	-
6.5	Nga trafiku gjate ndertimit ose shfrytezimit?	Po	Nuk do ketë ndikime mjedisore	Jo (punimet do kryhen ne orare dhe kushtet adeguate per te mos penguar trafikun)
6.6	Nga proceset e ndricimit ose ftohjes?	Jo	-	-
6.7	Nga burimet e rezatimit elektromagnetik (efektet mbi pajisjet dhe njerezit) ?	Po	Nuk do ketë ndikime mjedisore	Jo
6.8	Nga cdo burim tjetër?	Jo	-	-
7. A do te coje projekti ne rrezike te ndotjes se tokes ose ujit nga shkarkimrt e ndotesave ne toke ose ne kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza, ujrart sipërfaqesor, nentokesor, bregdetare ose ne det?				
7.1	Nga perpunimi, depozitimi, perdorimi ose shkarkimi i materialeve te rrezikshme e toksike?	Jo	-	-
7.2	Nga shkarkimet e ujrave te zeza ose rjedhjeve te tjera (trajtuara e patrajtuara) ne ujl ose toke?	Jo	-	-
7.3	Depozitimi i ndotesve te shkarkuar ne ajer, ujl ose toke?	Jo	-	-
7.4	Nga cdo burim tjetër?	Jo	-	-
7.5	A ka rrezik te ndonje akumulimi afatgjate te ndotesve ne mjedis nga keto burime?	Jo	-	-
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjate ndertimit apo shfrytezimit te projektit qe mund te ndikojne ne shendetin e njerezve apo mjedisin?				
8.1	Nga shperthime, zjarre, nxjerje etj. nga depozitimi, perdorimi e prodhimi i substancave te rrezikshme e toksike?	Jo	-	-

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

8.2	Nga ngjarje qe kapercojne kufijet e mbrojtjes normale te mjedisit, p.sh. demtimi i sistemit te kontrollit te ndaljes?	Jo	-	-
8.3	Nga ndonje shkak tjetere?	Jo	-	-
8.4	Mund te ndikohet projekti nga fatkeqsi natyrore qe shkaktojne deme per mjedisin(permbajtje, terrmete,shkarje dheu etj.)?	Jo	-	-
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, si p.sh. demografi, menyre tradicionale jetese, punesim?				
9.1	Ndryshime ne madhesine e popullsise, moshen, strukturen, grupet sociale etj.?	Jo	-	-
9.2	Nga strehimi i njerezve apo prishja e shtepive, mjediseve te komunitetit, si shkolle, spitale, mjedise sociale?	Jo	-	-
9.3	Nepermjet migrimit te banoreve te rinj ose krijimit te komuniteteve te reja?	Jo	-	-
9.4	Nga realizimi i kerkesave ne ritje per mjedise e sherbime sociale, si strehim, arsim, shendet?	Jo	-	-
9.5	Nga krijimi i vendeve te punes gjate ndertimit ose shfrytezimit apo humbjes se vendeve te punes me pasqja ne papunesi e ekonomi?	Po	Impakt pozitiv	Impakt pozitiv nga hapja e vendeve te punes
9.6	Ndonje shkak tjetere?	Jo	-	-
10.1	A do te coje projekti ne presione per zhvillime te metejshme qe do te kete ndiken te caktuar ne mjedis, si: me shume strehim, ruge te reja, industri, apo sherbime publike mbeshtetesete reja?	Po	Impakt pozitiv	Ritje e aktivitetit te sherbimit mbeshtetes,permisim te furnizimit me energji elektrike.

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

10.2	A do te coje projekti ne zhvillimin e mjedisve mbeshtetese, ne zhvillime ndihmese ose zhvillime te nxitura nga projekti qe mund te kete ndikim ne mjedis, si: 1. Infrastruktura mbeshtetese (rruge, furnizim me energji elektrike, trajtim te mbetjeve ose ujrave te perdorura etj.) 2. Zhvillim i strehimit; 3. Industri nxjerrse (ekstraktuese); 4. Industri funksuese; 5. te tjera	Po	Projekti do te coje ne zhvillimin e mjedisve mbeshtetese, si infrastrukture mbeshtetese ne furnizimin dhe per miresimin me energji elektrike.	- Impakt pozitiv
10.3	A do te coje projekti ne nje riperdorim te kantjerit pas shfrytezimit te tij qe do te kete nje ndikim ne mjedis?	Jo	-	-
10.4	A do te coje projekti ne krijimin e nje precedentit per zhvillime te me voneshme?	Po	Impakt pozitiv	Precedente per ndertim te bizneseve
10.5	A do te kete projekti pasoja kumulative per shkak te afersise me projekte te tjera ekzistuese ose te planifikuara e me pasoja te ngjashme?	Po	Impakt pozitiv	Po, ndertime te reja, qendra biznesi me mundesi te furnizimit me energji elektrike, per miresim dhe eficence te larte.

Për realizimin e këtij projekti do të jetë e domosdoshme germimi dhe pastrimi i hapësirës së sipërfaqes së tokës ku do të realizohet ndërtimi i nën stacionit të ri Tec Kombinat 110/20kV, ndërtimi i linjave të reja 20 kV, për zonën e Kombinatit në Tiranë. Pasi të ketë përfunduar faza e ndërtimit të nën-stacionit të ri, do të prishet edhe godina ekzistuese e cila është brenda rrethimit të territorit ekzistues.

Pra gjatë kryerjes së këtyre operacioneve do të ketë krijim të pluhurave të kontrolluar, nga ana e zbatuesve të projektit, të cilët janë të detyruar të zbatojnë rregulloren e kontrollit të sasisë së ndotjes, si rezultat i punimeve të ndryshme që do të realizohen gjatë ndërtimit të projektit. Ndikim tjetër gjatë zbatimit të objektit, është dhe krijimi i zhurmave, nga makineritë gjatë fazës së ndërtimit. Por duke konsideruar që nën-stacioni është jashtë zonës së banueshme, ky ndikim do të jetë në nivele të ulta tek banorët e kësaj zone.

Zhurmat

Gjatë ndërtimit të rrjetit elektrik do të ketë angazhim të makinerive për punime gërmimi, transporti materialesh, etj.

Për të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe të zhurmave që e shoqërojnë atë, me qëllim uljen e shqetësimeve për popullatën që jeton përreth zonës së realizimit të projektit, si rrugë të përkohshme do të përdoren ku të jetë e mundur rrugët dytësore.

Transportimi i materialeve të ndërtimit në rrugët egzistuese do të programohet me kujdes për të shmangur cdo shqetësim në trafikun lokal. Gjatë natës, automjetet e ndërtimit do të kërkohet që të operojnë me shpejtësi të ulta dhe do të ndaloher përdorimi i borive.

Ndikimet në ujërat sipërfaqësore.

Zbatimi i këtij projekti nuk lë shkas për ndotjen e ujërave rrjedhës sipërfaqësore nga ndotës të ndryshëm si karburantet, lëndët helmuese etj.

Nuk pritet të ndodhë qoftë dhe ndonjë ndotje indirekte që mund të rezultojë nga shkarkimet në tokë, e më pas të shpëlahen nga rreshjet, pasi ato nuk do të përdoren gjatë zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

Ndikimet në ujërat nëntokesorë

Zbatimi i projektit gjithashtu dhe shfrytëzimi i tij nuk krijon ndikim në ujërat nëntokësore, në këtë rast nuk kemi punime të cilat prekin apo ndikojnë ujërat nëntokësorë të zonës.

Perdorimi i tokës

Ndërtimi i Nën Stacionit Tec Kombinat 110/20kV, Tiranë nuk krijon shqetësim për komunitetin përreth, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe në fazën e shfrytëzimit, pasi ato pas perfundimit të zbatimit të projektit do të jene të padukshme, dhe nuk do të krijojnë asnjë shqetësim për pjesën vizuale tek banorët.

Punimet e ndërtimit do të vazhdojnë për një periudhë të përcaktuar kohe (sipas kushteve të parapërcaktuara nga specialistët e zyrave të prokurimit, të cilët do të përcaktojnë afatet kohore të fillimit dhe përfundimit të punimeve) dhe nuk do të

krijohen dëmtime të tokës, përveç asaj sipërfaqe të tokës në cilën do të kryhen gërmime për kanalet e ujërave në cilën do të ndërtohet zbatimi i projektit

Ndikimi në popullsi

Ndërtimi i rrjetit elektrik në këtë zonë nuk ka për të sjellë probleme për komunitetin e kësaj zone. Realizimi i këtij projekti, duke mos patur nevojë për krijimin e linjave rezerve për furnizim me energji elektrike, nuk do të shkaktojë ndryshime në popullsi të saj, apo zhvendosje të saj për shkak të këtij aktiviteti.

Ndërkohë duhet të theksojmë që zhvillimi i rrjetit të elektrik 20 kV në këtë zonë do të ketë avantazhe të mëdha për biznesin e ngritur në këtë zonë.

Planet në perspektivë për shtrirjen që do të ketë zonë në një të ardhme të afërt, kjo e

bazuar dhe në studimin urbanistik zonal të miratuar, si dhe vetë situata shumë e veshtirë energjetike që po kalon vendi ynë e rajoni në përgjithësi, flasin për domosdoshmërinë e fillimit sa më shpejt të këtij projekti.

Ndërkohë duhet theksuar dhe fakti që në këtë aktivitet mendohen të punësohen një numër i konsiderueshëm punonjësish duke zbutur sado pak plagën e papunësisë.

Ndikimet në peisazh

Kemi theksuar se karakteristikë e ndërtimit të nën stacionit të ri është ruajtja dhe mos ndryshimi i peisazhit dhe mjedisit në zonë, ndaj peisazhi nuk ka për të patur asnjë dëmtrim dhe nuk do të ketë nevojë për rigjenerim për periudhën e ndërtimit dhe shfrytëzimit të këtij objekti.

Peisazhi në këtë zonë është brenda konturit estetik të një zone tregëtare, sociale dhe banimi e ndërtuar vite më parë por që vazhdon përsëri të ndërtohet. Pra është një zonë në zhvillim të vazhdueshëm.

Në këtë zonë janë të pranishëm objekte shërbimi; ambiente ndihmëse, lokale, magazina e ekspozita për artikulim të ndryshëm, objekte për prodhime tregëtare, sociale dhe banimi, objekte të cilat janë ndërtuar bukur me estetike, me parametra bashkëkohore, çka i jep zonës pamjen e një zone dhe mjedisi tregëtare, sociale dhe banimi.

Ndikimet e rrjetit elektrik 20kV mbi trashëgimie arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera njerëzore

Si rezultat i ndërtimit të nën stacionit të ri në këtë zonë, nuk ka dhe nuk do të ketë ndikime negative mbi trashëgimie arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerëzore, sepse në zonë dhe përreth saj, nuk ka objekte të një rëndësie të vecantë të karaktereve të mësipërme.

Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë

Qëllimi i projektit lidhet me ndërtimin e nën stacionit të ri Tec Kombinat, Tirane, për prespektiven e kesaj zone.

Ndër objektivat themelore të këtij aktiviteti është prodhimi i energjisë elektrike ndërkohë që mungesa e saj po krijon shumë probleme në Shqipëri edhe në rajon.

Parashikohet të kryhet mbjellja e pemëve, e cila ka një rol të rëndësishëm në lidhje me parandalimin e erozionit, i cili shprehet me kombinimin e indeksit të Rrezikut Potencial të Erozionit (indeksi erodibilitetit x indeksin e erozionit x indeksin e pjerrësisë) dhe indeksin e vegjetacionit (shkalla e mbuleses bimore). Si përfundim masat zbutëse kundër erozionit janë në të dyja nivelet, masa hidroteknike dhe biologjike

NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLGJI

Flora.

Zona e Tiranës bën pjesë në brezin e shkurreve dhe drurëve mesdhetare ku përmendim pyjet gjethegjere. Në zonat përreth vazhdojnë të mbijetojnë në pakicë si: makiet, shiblaku, driza (paliurus spina-christi), cermedelli (cotunus coggygria), shqemla (rhus corlaria), shege (punica granatun), gorrice (pyrus amygdallformis), murrizet, thana, etj.

Në këtë zonë janë mbjellë bimë zbutuese (Pinus nigra, Picea conica, Talus baccata, Juniperus virginiana, etj), një pjesë e mirë e tyre nga kontributet individuale nga biznesi vëndas.

Fauna.

Zona në studim nuk dallohet për ndonjë botë të pasur shtazore. Si zonë në periferi të Tiranës, është pjesë e Bashkisë Tiranë, karakteristike janë harabelat. Për zonën në studim nuk zotërohet ndonjë material i hollësishëm.

Prania e kafshëve të egra në këtë zonë mungon totalisht, për më tepër aty ka kafshë shtëpiake siç janë qentë pasi zona është e mbushur me ndërtime. Zogjtë që karakterizojnë zonat përreth janë si: pëllumbi (*Streptopelia decaoto*), trumcaku (*Troglodytes*), harabela (*passer domesticus*), kumriet, etj. Ndërsa insekte kemi brumbuj, grerëza, milingona, pilivesa, mushkonja, flutura etj. Nuk vihen re prania e ndonje specie që është e përfshirë në "Librin e Kuq".

Zona siç është përshkruar edhe më lart, nuk është e mbushur me bimësi. Fauna e zonës, sidomos ajo ujore, nuk pëson ndonjë ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt.

Aktiviteti i ndërtimit e shfrytëzimit nuk sjell influencë negative në folenizim, shumëzim, etj. Gjatë fazës së shfrytëzimit nuk ka elemente të shqetësimit për demtimin e faunës.

Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones është e paprekshme nga ndikimet e ndërtimit të rrjetit elektrik, për arsye së aktiviteti i ndërtimit dhe shfrytëzimit nuk dëmton as në lloje e as në numër elementet e florës dhe faunës, si pjesë përbërëse e këtij rajoni.

Ndërtimi i fiderave dhe fuqizimi i nën stacionit në këtë zonë të Tiranës do jetë një ndihmë e madhe për këtë zonë për vetë kushtet për kërkesën e madhe për energji elektrike që po kalon vendi ynë dhe rajoni në përgjithësi.

Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Në pikëpamje të strukturës gjeologjike dhe pamjes së relievit, kjo zonë nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka asnjë arsye të vlerësohet ose të merret parasysh gjatë këtij aktiviteti. Kjo zonë përbën një peisazh të zakonshëm gjeologjiko-gjeomorfologjik, karakteristike e këtij rajoni.

Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.

Gjate ndërtimit të nën stacionit të ri Tec Kombinat 110/20kV Tirane, do të ketë ndryshime pothuajse të papërfillshme të topografisë lokale. Në projektet e tij janë parashkruar një rradhe nderhyrjesh që në kombinim me masat e tjera suplementare të sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e mundshëm.

Në projekt është parashikuar një rradhe pune dhe drejtim i tillë, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, të parandalojnë fenomenin e erozionit.

Ndikimet në cilësinë dhe sasinë e tokës

Sipërfaqja në të cilën do të zbatohet projekti "Ndërtim i nën stacionit të ri Tec Kombinat 110/20kV Tiranë" nuk është tokë bujqësore, realizimi i projektit do të bëhet në të njëjtin territor, ku aktualisht është nën stacioni ekzistues 35/6kV Tec Kombinat Tiranë.

Ndikimet në ujë

Ndërtimi i nën stacionit të ri Tec Kombinat 110/20kV Tiranë, nuk sjell asnjë problem në ndikimet e pritshme në ujë. Në çdo kohë do të plotësohen nevojat e komunitetit për çdo aktivitet që kërkon përdorimin e ujit.

Zbatimi i projektit nuk do të ndikojë negativisht në ujërat sipërfaqësore.

Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikim në cilësinë e ujit. Pra realizimi i ndërtimit të objektit nuk e prish cilësinë e ujit.

Ndikimet ne ajer

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikim në cilësinë e ajrit të zones, pasi gjatë shfrytëzimit nuk do të ketë emetime të gazrave dhe sasia e pluhurave që mund të krijohen gjatë fazës së ndërtimit të objektit do të merren masa për mbajtjen nën kontroll të tyre, duke kryer spërkatje me ujë.

Ndikimi ne klime

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka ndikim në klimën e kësaj zone.

Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerojne projektin.

Projektet e tjera si p.sh. rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, telekomunikacionet, etj. nuk do të ndikojnë në realizimin e këtij projekti, pasi në zonën që prek ky projekt nuk ka elemente të infrastrukturës sic u përmenden më lart.

Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara.

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e infrastrukturës rrugore, si dhe në rritjen e nivelit social-ekonomik në zonë.

Ekspozimi i fushës elektromagnetike

Fusha elektromagnetike gjenerohet nga fusha elektrike (E) dhe nga fusha magnetike (H). Në përballje me lloje të ndryshme të energjisë elektromagnetike kur përdorim pajisje si mikrovala, kompjuteri, radioja dhe televizori dhe rrjetat celulare.

Rrezatimi elektromagnetik mund të klasifikohet në rrezatim jonizues dhe jo-jonizues bazuar në aftësinë për të jonizuar atomet dhe për të thyer lidhjet kimike. Radiofrekuencat e përdorura në tensionin e lartë elektrik janë të tilla që rrezatimi i shkaktuar prej tyre nuk shkakton jonizim prandaj quhet rrezatim jo-jonizues. Rrezatimi jo-jonizues lidhet me dy rreziqe potenciale: elektrike dhe biologjike. Një rrezatim elektromagnetik shumë i lartë mund të shkaktojë rryma elektrike sa të mund të krijojnë shkëndija (hark elektrik) kur një voltazh i induktuar kalon voltazhin e thyerjes të mjedisit rrethues. Efekti biologjik i rrezatimit të fushave elektromagnetike shkakton nxehje dielektrike. Ekzistojnë edhe efekte komplekse biologjike të fushave elektromagnetike jo-termike duke përfshirë fushat magnetike me frekuenca ekstremisht të ulëta, radiofrekuencat e moduluara dhe fushat e mikrovalëve.

Ndikimi i fushave të dobëta elektromagnetike në trupin e njeriut arrihet si pasojë e disa ngjarjeve të cilat përfshijnë ekspozimin nga rrezatimet elektromagnetike i cili pasi përthithet modulon strukturat biologjike, akumulon energji në lëngjet e trupit, shkakton ndryshime në aktivitetet funksionale të qelizës të cilat me pas shkaktojnë disa sëmundje. Numri i përdoruesve të celularëve është rritur eksponencialisht së fundmi dhe celulari është bërë një mjet i domosdoshëm për njerëzit. Kjo gjë ka rritur dhe rrezatimin elektromagnetik të mjedisit në tërësi. Vlerësimet e ekspozimit në radio frekuencë nga fusha elektromagnetike mund të ndahen në dy kategori:

- vlerësimi i fushës rënëse, domethënë kuantifikimi i fushës elektromagnetike
- kuantifikimi i fushës elektromagnetike të induktuar nga trupat biologjikë

Në shumicën e rasteve të vlerësimit verifikimi që vlerëslmi aktual është më poshtë se ndonjë vlerë e caktuar është i rëndësishëm për përcaktimin e saktë të ekspozimit individual. Fusha e induktuar është i vetmi parametër i fushës që mund të bashkëveprojë me proceset biologjike dhe për këtë referohet si sasia primare. Shpërndarja e fushave të induktuara në radiofrekuenë është një funksion kompleks me shumë parametra si frekuenca, fuqia e fushës rënëse, këndi i rënies, impendanca e fushës, polarizimi, madhësia dhe forma e trupit biologjik, shpërndarja e indeve, karakteristikat dielektrike, etj. Në përgjithësi dinamikat e fortësisë së fushës së induktuar renditen në disa shkallë madhësie. Me fjalë të tjera, fuqia dhe shpërndarja e fushave të induktuara nga i njëjti ekspozim rënës ndryshon shumë me anatominë dhe orientimin e trupit në lidhje me fushën. Figura 2.1 paraqet spektrin elektromagnetik dhe pajisjet karakteristike.

Vlerësimet teorike e eksperimentale kërkojnë instrumente të sofistikuara, ekspertizë të detajuar dhe kohë. Megjithatë janë zhvilluar teknika dhe metoda të thjeshta për t'u aplikuar duke përdorur një qasje të rastit më të keq për të përcaktuar një përputhje me fushat e induktuara potencialisht të rrezikshme duke përcaktuar fushat rënëse. Nga koncepti i rastit më të keq rrjedhin kushtet për fushat e induktuara maksimale brenda një vëllimi të caktuar për një fortësi të fushës rënëse në termat e polarizimit, shpërndarjes së fushës, impendancës së fushës, dhe e cilësive të saj dielektrike.

Spektri Elektromagnetik



Ndikimet ne mjedis gjate faze se operimit

Një nga efektet më të diskutueshme të projektit dhe linjës të transmetimit të tensionit të lartë apo të mesëm, është efekti i fushëve elektrike dhe magnetike në qëniet njerëzore dhe në mjedis në përgjithësi. Për këtë do të ndalemi në efektet e mundshme që mund të sjellin në qëniet njerëzore.

Rrymat Endogjene dhe Rrishti i Tyre.

Fushat elektrike dhe magnetike, gjithnjë cojnë në krijimin dhe induktimin e rrymave elektrike endogjene. Dhe pikërisht me to lidhen të gjitha mekanizmat e veprimit biologjik, të njohura dhe të panjohura. Për këtë arsye janë bërë përpjekje për të përcaktuar marrëdhënjet ndërmjet tyre dhe rrisqeve e pasojave që ato mund të japin në mjedis apo në shëndetin e njerëzve. I parë në këtë këndvështrim ky problem edhe sot mbetet i hapur, ai reduktohet në përcaktimin e limiteve të rrymave endogjene, pra të fushave elektrike (E) dhe atyre magnetike (B) të lejuara për ekspozimin e njeriut. Gjatë këtyre viteve janë bërë përpjekje për të ulur rrishtin dhe ndikimet në mjedis.

Efektet biologjike te fushave elektromagnetike.

Fushat elektromagnetike kane efekte potenciale mbi shendetin e njeriut.

Gjate nje vezhgimi 9-vjecar ne vitin 1990 -1999, ekzaminimet klinike te pergjithshme dhe te specifikuar vune ne dukje se konstantet hematologjike dhe biokimike EKG, dhe EEG, testet biologjike, te funksionimit te veshkave, te tiruideve, te organeve gjentiale, etj, nuk paten ndryshim sinjifikative per tu shqetesuar.

Per te plotesuar analizen perkatese duhet te shqyrtohet edhe shperndarja e fushes magnetike d.m. th densitetin e saj ne hapesiren e linjes. Duhet te veme ne dukje se prania e tokes nuk e prish njetrajtshmerine e mjedisit ndaj dhe fusha magnetike nuk peson deformime.

Kurora eshte nje dukuri e shpeshte e linjave te tensionit te larte si atij te vazhduar dhe atij alternativ. Ne rastin e pare nuk flitet per karakter ofensiv te fushes elektromagnetike si ne rastin e dyte, por vihen ne dukje disa probleme qe lidhen me jonet e krijuara nga kurorat.

Dukurja e kurores lidhet me shkarkimet ne ajer te fushes elektromagnetike.

Dihet se jonet kane efekte shqetesuese per shendetin e njeriut.

Jonet jane nje oksidant shume aktiv qe mund te kene efekte toksike per qeniet e gjalla. Ndermjet tyre mund te permendim, dhimbjen e kokes, migrenes, shqetesime nga stomaku dhe te vjella, problemet e frymemarrjes dhe shqetesime te syve dhe te veshëve.

Organizata Boterore e Shendetesise dhe shume institucione te tjera shendetesore shteterore e kane konsideruar te pershtatshme qe ne funksion te kujdesit qe duhet treguar, ne varesi te ekspozimit dhe kohezgjatjes se tij, rekomandojne kujdes me te gjere ose me te ngushte.

Ne vitin 1978 Komiteti Shendetesor i shtetit te Neë York-ut, terhoqi vemendjen lidhur me efektet e mundeshme qe rezultojne nga linjat e tensionit te larte, me synim percaktimin e tensionit maksimal te ekspozuar te autorizuar dhe largesite e sigurise, apo korridoret perqark linjes. Si vlerë limit u vendos tensioni 160 kv/m.

Ne nje raport te Agjensise Amerikane Le Mbrojtjes se Mjedisit bere ne vitin 1990 per vleresimin e literatures shkencore, thuhet se: *"Si perfundim shume studime te analizuara kane treguar se kemi nje rrisht shume te ulet te leucemise, te kancerit per punonjesit qe jane te ekspozuar karshi fushes elektrike"*.

Sipas Organizates Boterore te Shendetesise, ne nje raport thuhet se duhet bere kujdes qe femijet te mos ekspozohen ndaj fushave elektromagnetike intensive per te shmangur riskun e mundshem ndaj semundjes se leucemise.

Per te qene te sigurte linjat duhet te ndertohen ne korridore 30 - 50 m larg zonave te banuara dhe nenstacionet e tensionit te larte duhet te ndertohen 70-100m larg zonave te banuara.

Perfundimi i arritur ne normat e mesiperme eshte se nen driten e treguesve qe sjell me siper fusha elektromagnetike e linjave te tensionit te larte dhe te mesem te rrjetit transmetues jane shume larg limiteve te Rekomanduara.

Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare

Nje nga problemet e dites ne shume vende te zhvilluara eshte shqyrtimi rrezatimit jonizues i fushave elektromagnetike. Perpjekjet behen per te percaktuar Standartet dhe masat qe duhen marre ne realizimin e tyre.

Ky veshtrim relativ i problemit ka cuar ne faktin qe hasin Standartet e ndryshme qe kane qellim te luajne rolin e masave parandaluese. Per te shmangur pasojat e mundshme te rrezatimeve elektromagnetike, vlerat e ketyre standarteve vijne ne ulje.

Duke patur parasysh problemin e rrymave endogjene, pike referimi e ndertimit te normes eshte marre dendesa e rrymes se importuar prej 10mA/m², pra kjo eshte norma baze referuese.

Kjo rryme ka ne korespondence ekspozimin e njeriut ne fushe elektrike me gradient 25 kv/m Organizata Boterore e Shendetesise dhe shume institucione te tjera shendetesore shteterore e kane konsideruar te pershtatshme qe ne funksion te kujdesit qe duhet treguar, ne varesi te ekspozimit dhe kohezgjatjes se tij, te rekomandojne kufij me te gjere ose me te ngushte.

Perfundimi i arritur ne normat e mesiperme eshte se nen driten e treguesve qe sjell me siper fusha elektromagnetike e linjave te tensionit te larte dhe te mesem te rrjetit transmetues jane shume larg limiteve te rekomanduara me siper pra nuk kemi te bejme me shqetesime shendetesore.

MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Masat e sigurimit teknik ne pune

Mbrojtja ne pune dhe ruajtja e shendetit te punonjesve qe do te punojne ne ndertimin dhe shfrytezimin e projektit do te realizohet duke zbatuar rregullat e sigurise dhe mbrojtjes ne pune.

Gjate ndertimit duhet te jene ne qender te vemendjes problemet e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune, pasi keto jane me te rendesishmet dhe qe kerkojne nje vleresim shume serioz nga ana e drejtuesit te punimeve.

- Para se gjithash ne te gjithë operacionet duhet te punësohen specialistë me eksperiencë pune në këtë fushë.
- Drejtuesi teknik i punimeve duhet të bëjë instruktimin teknik të punonjesve, sipas kërkesave të rregullores për këto punime.
- Në mjediset që do të punohet do të jetë gjithmonë kutia e ndihmës së shpejtë, dhe të jetë e mbyllur me kyç dhe të mbahet nga një punonjës që do të jetë gjithmonë i gatshëm.
- Punëtorët që do të punojnë duhet të jenë të pialsur nga firma me të gjitha mjetet mbrojtëse si kapele plastike, rroba pune, dorashka, etj.
- Punonjësit duhet të jenë të instruktuar për rastet e rënies së zjarrit si dhe për rastet e aksidenteve në punë.

Mbrojtja ne pune dhe ruajtja e shendetit te punonjesve qe do te punojne ne do te realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik për punimet me tensionë të larta,
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektoriali i Higjenes së Punës.
- Garancinë e lëndeve të para si të padëmshme për shëndetin e puntorëve në të gjitha fazat e punës me to.

Operacionet e punës kërkojnë përdorimin e veshjeve personale speciale për të realizuar mbrojtjen nga tensionet e rrymës elektrike dhe të zhurmave. Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë dy detyrat kryesore të stafit drejtues dhe i punonjësve.

Mbrojtja e mjedisit

Rrjeti elektrik do të zhvillohet në harmoni me vlerat e natyrës.

Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte:

- 1) *sistemimi i materialit inert te krijuar nga keto punime,*
- 2) *sistemimi i brgjeve dhe shpateve per te evituar fillimin e erozionit.*

Pra mund të themi se nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta, apo të ngurta
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave.
- Zhurmat në mjediset e punës do të jenë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
- Nuk ka çlirim të aromave të ndryshme, elj
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lageshtisë në mjediset e punës.
- Janë parashikuar marrja e të gjitha masave për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

Masat e marra per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet.

Sic u theksua dhe me lart, mund të pohohet se rreziku ne mjedis në zanën që do të realizohet projekti i nën stacionit të ri është i minimizuar deri në atë shkallë sa mund të themi se nuk do të jetë prezent.

Ndër masat e marra në rast rënije zjarri, do të ndodhen të instaluarat implantet e mbrojtjes kundër zjarrit.

Për reagimin e menjëhershëm ndaj aksidenteve të mundëshme humane do të ketë edhe një mjedis të mbyllur ku mbahet kutia e ndihmës së shpejtë dhe do të vendosen mjetet personale të punonjësve. Për uljen e rrezikut të aksidentimit të punonjësve nga mjetet e transportit gjatë fazës së ndërtimit, megjithëse ato do të jenë të pakta në numër, nuk do të lejohet të ecin më shumë se 40 km/ore.

MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ne perputhje me Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie" eshte ndertuar matrica e ndikimeve te projektit " Nderitim i nenstacionit te ri Tec Kombinat 110/20kV Tirane, ndertimit te rrjetit te ri 20kV dhe rrjetit TU ne zanen e Kombinatit ne Tirane, gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te tij.

Matrica eshte ndertuar ne perputhje me Aneksin II te pjeses se dyte te ketij udhezimi

Matrica e ndikimeve ne mjedis

Tipare te mjedisit te projektit, te cilat mund te ndikohen nga projekti lokal apo pereth vendodhjes se projektit	Identifikimi i ndikimit ne mjedis			
	Ne ndertim		Ne shfrytezim	
	Po	Jo	Po	Jo
Zona te mbrojtura nga legjislacioni per vlerat e tyre ekologjike, peisazhe, kulturore		X		X
Zona te tjera te rendesishme ose te ndjeshme per arsye te ekologjisee tyre				
a. ligatina		X		X
b. rjedhje ujore ose trupa te tjere ujore		X		X
c. zona bregdetare		X		X
d. male		X		X
e. pyje		X		X
Zona te perdorura nga specie te mbrojtura, te flores e faunes, per kygezim, folelizim, ushqim, pushim, dimerim, migrim		X		X
Ujrat e brendeshme, tokesore, bregdetare, detare e nentokesore		X		X
Zona me vlera te larta peisazhi e skenike		X		X
Rruge ose mjedise te tjera te perdorura nga publiku per pushime ose aktivite te tjera.		X		X
Rruge transporti qe jane te mbingarkuara		X		X
Zona me rendesi historike e kulturore		X		X
Vendosja e projektit ne nje zone shume te dukshme nga shume njerez		X		X
Humbje te tokes se gjelber		X		X
Perdorime ekzistuese te tokes ne/ose reth vendit te zbatimit te projektit, qe ndikohen nga projekti				
a. shtepi, oborre ose prona te tjera private		X		X
b. industri		X		X
c. tregell		X		X
d. rekreacione		X		X
e. hapësira publike		X		X
f. mjedise te komunitetit		X		X
g. bujqesi		X		X
h. pyje		X		X
i. turizem		X		X
j. miniera		X		X

Plane perdorime te ardhshme te tokes te cilat mund te ndikohen prej tij	X		X
Zona me densitet te larte populsie e ndertimesh	X		X
Zona te zena nga perdorime te ndjeshme te tokes			
1. spitale	X		X
2. shkolla	X		X
3. vende kulti	X		X
4. mjedise te komunitetit	X		X
Permbajtja ne zone e burimeve te rendesishme, me nje cilesi te larte ose te pakta te cilat mund te ndikohen			
1. burime ujrash nentokesor	X		X
2. ujra sipersfaqesore	X		X
3. pyje	X		X
4. bujqesi	X		X
5. peshkim	X		X
6. turizem	X		X
7. minerale	X		X
Zone subjekt i ndotjes ose demtimeve mjedisore p.sh, ku standartet ekzistuese mjedisore jane tejkaluar	X		X
Zone e ndjeshme ndaj termeteve, reshqitje toke, erozionit, permbytjeve ose kushteve klimatike	X		X
Ndryshime ne kushtet fizike te ndonje nga perberesit mjedisor			
1. mjedisi atmosferik	X		X
2. uji- sasia, rjedhat ose nivel i lumit, liqenit, uji nentokesor	X		X
3. grykederdhjet, uji bregdetar ose detar			
4. toka-sasia, thellesi, lageshti, qendrueshmeri, erodibilitet	X		X
5. kushtet gjeologjike dhe te sipersfaqes se tokes	X		X
Shkarkimet nga zbatimi i projektit te ndikojne ne cilesine e perberesve mjedisore			
1. cilesia e ajrit lokal	X		X
2. cilesi e ajrit global, ndryshim klimatik, ngushtim i shtreses se ozonit	X		X
3. cilesi e ujit: lumenj, liqen, ujra nentokesor	X		X
4. grykederdhjet, ujrart bregdetare ose detare	X		X
5. statusi ushqyes dhe eutrofikimi i ujrave	X		X
6. acidifikimi i tokes ose ujrave	X		X
7. toka	X		X
8. zhurmat	X		X
9. temperatura, rezatimi ndricues e elektromanjetik	X		X
10. produktiviteti i sistemeve natyrore ose bujqesore	X		X
Ndikimi ne disponibilitetin apo pamjaftueshmerine e burimeve te mundshme ne nivel lokal ose global			

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

1. Karburantet	X	X
2. Ujrat	X	X
3. Minerale dhe agregate	X	X
4. Lende drusore	X	X
5. Burime te tjera jo te rinovueshme	X	X
6. Kapacitetin e infrastruktures ne vend	X	X
Ndikimi ne shendetin ose mireqenien e komunitetit		
1. Cilesine e ajrit, ujit, ushqimit	X	X
2. Semundje ose vdekshmeri e komuniteteve ekspozimi ndaj ndotjes	X	X
3. Shfaqje ose shperndarja e bartesve te semundjeve	X	X
4. Ndjeshmeria e Individove te vecante, komuniteteve ndaj semundjeve	X	X
5. Perceptimi individual i sigurise personale	X	X
6. Kohezioni dhe identiteti i komunitetit	X	X
7. Identiteti kulturor dhe shoqatat	X	X
8. Te drejtat e minoriteve	X	X
9. Kushtet e strehimit	X	X
10. Punesimi	X	X
11. Kushtet ekonomike	X	X
12. Institucionet sociale	X	X

Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe te Shfrytezimit

Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe te Shfrytezimit te projektit te nen stacionit elektrik jane ndertuar ne perputhje me Udhezimin Nr. 6, date 27. 12 2006 " Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie". Pyetesori i prezantuar ne Aneksin 2 te pjeses se trete te udhezimit eshte perceptuar dhe zgjeruar mbeshtetur ne eksperiencen bashkohore te vleresimit te ndikimit ne mjedis .

Nr .	Lloji i ndikimit	Identifikimi i ndikimit		
		Gjate Ndertimit		Gjate Shfrytezimit
		Po /Jo	Argumento	Argumento
Perdoret ne nevojat banor				
1.1	Ndryshimet ne popullsi si rrjedhoje e projektit te zhvillimit, dhe ndikimet pasuese mjedisore si rezultat i kesaj.	Po	Do te ndihmoje ne permiresim te furnizimit me energji elektrike te zones dhe punesimin e banoreve te zones, raste te nevojshme.	Po (Permiresim i funizimit me energji, si rrjedhoje e ndertimit te nen stacionit dhe linjave 20kV ne kete zone)
1.2	Ndikimet e dukshme te projektit te zhvillimit ne zonat rrethuese dhe paisazh	Jo	Veprimtaria do te ushtrohet brenda nje siperfaqe te kulizuar, ndikimet e dukshme te zhvillimit apo ne paisazh	Jo (Do te influencoj ne zhvillimin e jetes se banoreve te zones duke rritur furnizimin me energji elektrike)

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

			nuk ka.	
1.3	Nivelet e ndikimit e emetimeve te ardhura nga projekti i zhvillimit gjate fazes normale te veprimit	Jo	Palsjet per ndertimin dhe vendosjen ne eficence te nen stacionit do te jene, te percaktuara sipas specifikkmeve teknike, ne standarte me efikase.	Jo
1.4	Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti	Po	Ndikimet jane te ulta pasi do te kryhen sipas te gjitha kushteve teknike	Po (Teper te ulta dhe jo shqetesuese per punetoret e shfrytezimit.Nivelet e zhurmave jane brenda normave te lejuara)
1.5	Ndikimet e projektit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimet arkitektonike dhe historike, tipare arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerzore	Jo	-	Jo (nuk ka)
Ndikimet ne floren, faunen dhe gjeologjine.				
1.6	Humbja dhe demtimi i habitateve, specieve bimore dhe shtazore	Jo	-	-
1.7	Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike	Jo	-	-
Ndikimet ne toke				
1.8	Ndikimet fizike te projektit si, p.sh. ndryshimi ne topografine lokale, erozioni i tokes, etj.	Jo	Eshte zone e sheshte dhe pa premisa erozioni	Jo
1.9	Ndikimet e emetimeve kimike dhe te depozitimeve ne token dhe rrethinat ku do te zhvillohet projekti zhvillimit	Jo	-	-
1.10	Ndikime ne perdorimin e tokes dhe te burimeve	Po	Vetem siperfaqen ku do te ndertohet projekti.	Jo
Ndikimet ne uje				
1.11	Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones.	Jo	Nuk demton as modifikon modelin e drenazhimit te zones sepse operon ne nje siperfaqe te kufizuar	Jo
1.12	Ndryshimet e karakteristkave te tjera hidrografike, si p.sh. niveli i ujerave nentoksopre, i rrugeve ujore ,i rrjedhjes se ujerave nentoksore	Jo	-	Jo
1.13	Ndikimet e ndotesve, mbetjeve etj.	Jo	-	Jo
Ndikime e tjera indirekte dhe sekondare qe e shoqerojne projektin				

VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS

1.14	Ndikimet nga trafiku(ruga,hekurudha,ajri,uji) qe lidhen me projektin	Jo	(Do te zbatohet projekti ne orare te pa ngarkuara, do te perdoren rruge dytesore ateher kur eshte e mundur)	Jo
1.15	Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve,ujit,energji se ose burimeve te tjera si pasoje e projektit.	Jo	-	Jo
1.16	Ndikimet e projekteve te tjera qe shoqerojne projektin e dhene,si p.sh.rruget e reja,kanalet e ujerave te zeza,banesat,linjat e energji se,nafte dhe gaz-sjellesve,telekomunikacionit etj.	Jo	-	Jo (Qelimi i projektit eshte permbresimi furnizimit me energji elektrike.Ne kete konteks projekti do te kete vetem ndikime pozitive.)
1.17	Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara.	Jo	-	Po (Veprimtaria e ndertimit te N/Stacionit elektrik i projekteve te zhvillimit Industrial te zones.)

Plani i Masave Zbutese Dhe Monitoruese Mjedisore

Rubrikat e Punimeve	Impakti i mundshem negativ			
	Faza e ndertimit		Faza e F&M	
	Po (✓)	Jo (✓)	Po (✓)	Jo (✓)
Punime gerrmimi	✓		✓	
Punime instalimi te elementeve te nenstacionit		✓	✓	
Te ndryshme				
Kosto totale e masave per ruajtjen e mjedisit				200,000 Leke

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga analiza e tërë aspekteve të marra në shqyrtim në Raportin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis të projektit ndërtim i nën stacionit të ri Tec Kombinat 110/20kV Tiranë, zbatimi i projektit nuk do të ketë pasoja negative të matshme në mjedisin e zones, në krahasim me rëndesinë që ka objekti. Në këtë vleresim garantojmë një projekt lehtësisht të zbatueshëm dhe të menaxhueshëm nga investitori.

Projekti parashikon rehabilitimin e zones krahas ndërtimit. Kjo është arsyeja që subjekti bën propozimet përkatëse të dokumentacionin e përgatitur për t'u pajisur me *Vendim për VNM paraprake*.

Ndërkohë është me rëndësi që subjekti të këtë parasysh këto detyrime gjatë fazave të ndryshme të realizimit të këtij projekti:

Subjekti ndërtues të respektojë detyrimet e vëna në lejen e ndërtimit të miratuar nga pushteti lokal, lidhur me depozitimin e materialeve të dala gjatë punimeve të hapjes së trasesë. Të kryhet rehabilitimi i tokës ku do të realizohet ndërtimi i nën stacionit të ri.

Konkluzione dhe rekomandime si me pashte:

- Territori në fjalë nuk ka statusin e parkut kombëtar.
- Zbatimi i këtij projekti nuk do të ketë ndonjë pasojë negative të matshme në mjedisin e zonës.
- Do të kemi Përmirësim të furnizimit me energji elektrike dhe për situatën tepër të vështirë që po kalon vendi ynë dhe kërkesat gjithnjë e në rritje është një domosdoshmëri.
- Reduktim të impaktit mjedisor.
- Reduktim të impaktit social

Ndikime pritet të ketë vetëm në ndryshimin e një pjese të vogël të tokës. Masat që janë parashikuar në terren do ta zbusin këtë fenomen dhe do të cojnë në përmirësimin e tij.

Rekomandime:

- Të bashkëpunohet me autoritetet përkatëse, se cila do të jetë menyrë e trajtimit përfundimtar të mbetjeve të tjera që nuk janë të përfshira në kontratën e shërbimit.
- Të mbahen kontakte të vazhdueshme me komunitetin
- Të kryhen trajnime për punonjësit dhe nënkontraktorë të objektit, për njohjen e praktikave më të mira të ruajtjes së mjedisit.
- Të respektohen të gjitha kushtet dhe masat që do të vendosen nga Ministria e Mjedisit dhe ARM-së të qarkut Tiranë.

Hartoi raportin:

Q-Plan International Network of Experts

Expertize në përgatitjen e raporteve VNM dhe auditimin mjedisor
Licence kodit 3.2.A: Nr. LN-9248-03-2015

